

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KOMUNA GLLOGOC

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i prokurimit	611-25-2083-2-2-1
-----------------	-------------------

Sa i përket tenderit për: “Avancimi i programit të E-taksës”

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

CMD SH.P.K. nga (Zejnullah Fetahu B.I.)

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Nena Terezë, 40a, nr.2

(Adresa)

Prishtinë

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

+383-44-631-998

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Zejnullah Fetahu

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

contact@cmdsoftwares.com

(Adresa elektronike)

11.06.2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) s-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 18.03.2025
Data e hapjes së ofertave: 08.04.2025
Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 10.06.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 66 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 40 i RREGULLORES nr.001/2022 Për prokurim Publik.
Neni 10 i UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin të AK-së me dt.10.06.2025, ku është rekomanduar për kontratë OE “Tretek” SH.P.K , ndërsa neve na është dërguar letra standarde për tenderues të eliminuar.

Arsyet e eliminimit janë si në vijim:

ARSYETIM

[Ju jeni diskualifikuar] [Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :

[Deklaroni arsyet e hollësishme mbi refuzimin në përputhje me rrethanat]

Ne ditën e hapjes së ofertave statusi i kompanisë CMD SH.P.K në sistemin e ARBK figuron që është shuar.

Në lidhje me arsyet e lartcekura të eliminimit tonë ju sqarojmë se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pazotueshme, sepse ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njëkohësisht jemi OE me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Operatori Ekonomik **CMD SH.P.K.** është kompani e regjistruar në ARBK më **07.04.2025**, me numër unik të identifikimit **812266543**, me seli në Rr. Nënë Tereza, nr. 40a, nr. 2, Prishtinë, dhe është në pronësi të plotë të z. Zejnullah Fetahu. Kjo kompani është pasardhëse ligjore e biznesit paraprak

Zejnullah Fetahu B.I. – N.SH. CMD, me NUI: 810902876, e regjistruar që nga viti 2010.

Ndryshimi i formës juridike nga **B.I. në SH.P.K.** është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi, me synim rritjen e kapaciteteve organizative dhe administrative të biznesit.

Me datë 10.06.2025, **OE CMD SH.P.K.** është njoftuar për eliminimin nga procedura e prokurimit me arsyetimin se "në ditën e hapjes së ofertave, **CMD SH.P.K.** në ARBK figuron si i shuar".

Ky vendim është i pabazuar ligjërisht, pasi **CMD SH.P.K.** nuk është e re apo e pavarur, por është vazhdimësi e biznesit paraprak **Zejnullah Fetahu B.I.**, çka vërtetohet nga:

- Certifikata e regjistrimit në ARBK (07.04.2025)
- Certifikata e regjistrimit në ATK (08.04.2025)
- Njoftimi zyrtar për ndryshim të statusit juridik (22.04.2025)
- Certifikatat për B.I. që provojnë vijimësinë ligjore.

1. Vlefshmëria e regjistrimit komercial sipas nenit 66 të LPP-së

Sipas **nenit 66 të LPP-së**, një operator ekonomik që merr pjesë në aktivitetet prokurimi duhet të jetë i regjistruar në regjistrin profesional, komercial apo të ndërmarrjeve në vendin përkatës. Në rastin konkret, **oferta është dorëzuar me dokumentacionin e Zejnullah Fetahu B.I.**, i cili ishte aktiv dhe i regjistruar në momentin e ofertimit, ndërkohë që transformimi në **CMD SH.P.K.** është bërë në të njëjtën datë dhe është dokumentuar në ARBK. Nuk ekziston asnjë dispozitë në këtë nen që ndalon pjesëmarrjen për shkak të transformimit të formës juridike, përderisa aktiviteti afarist dhe regjistrimi komercial janë të pandërprera. Për më qarte në faqe 2 nga 4 të certifikatës së biznesit të **CMD sh.p.k.** pjesa "shënim me rëndësi", sqarohet qarte ndryshimi i statusit.

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number	
812266543	
Shënim me rëndësi / Important Note / Vazan podatak	
; Numri mëparshëm i biznesit është NRB: 70696169 , me zbatimin e ligjit për numrin unik të identifikues të biznesit ka këtë numër NUI: 810902876 Biznesi Individual me emër Zejnullah Fetahu B.I. dhe emër tregtar 'N.SH. " CMD " themeluar me 28/9/2010 si Biznes Individual me numër unik identifikues 810902876 dhe numër të biznesit 70696169 . Me datën: 07-04-2025 ky biznes e ndrron tipin në ' Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ' me emër të biznesit CMD SH.P.K. dhe merr numër të ri të biznesit 812266543 dhe është vazhdim i biznesit të mëhershëm.	

2. Përputhshmëria me nenin 3.16 të Rregullores Nr. 001/2022

Neni 3.16 i kësaj rregulloreje parashikon qartë se **ndryshimi i formës juridike të një operatori ekonomik (p.sh. nga B.I. në SH.P.K.) nuk përbën shkak për përjashtim**, përderisa ky ndryshim është reflektuar në sistemin e prokurimit. CMD SH.P.K. është trashëgues i plotë ligjor dhe ekonomik i Zejnullah Fetahu B.I., me të njëjtin pronar, adresë, aktivitet dhe staf.

3. Trajtimi i barabartë, ndalimi i diskriminimit dhe detyrimi për sqarime

Sipas **nenit 7.1 të LPP-së**, autoritetet kontraktuese kanë detyrim të trajtojnë operatorët në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim. Sipas **nenit 7.3**, ndalohet çdo praktikë që përjashton operatorët për arsye formale, përderisa ato nuk ndikojnë në kapacitetin për përmbushje të kontratës.

Gjithashtu, bazuar në **Udhëzuesin Operativ Nr. 001/2023, faqet 40–41**, autoriteti kontraktues **duhet të kërkojë sqarime** në rast të paqartësive rreth certifikatave të regjistrimit të biznesit, regjistrimit në TVSH apo numrit fiskal (referuar neneve 66 dhe 69 të LPP-së). Në këtë rast, AK ka vepruar në kundërshtim me këto dispozita, duke mos kërkuar sqarime për transformimin e formës juridike, pavarësisht se ndryshimi ishte i përditësuar dhe dokumentacioni ishte i qasshëm.

4. Parimi i ekonomicitetit dhe efikasitetit

Sipas **nenit 6 të LPP-së**, autoritetet kontraktuese kanë për detyrë të sigurojnë që fondet publike të përdoren në mënyrë ekonomike dhe efikase, duke marrë në konsideratë qëllimin e kontratës publike. Në këtë rast, përjashtimi i OE CMD SH.P.K., i cili ka ofruar **çmimin më të ulët ekonomikisht të favorshëm prej 11,920.00 €**, siç dëshmohet në **procesverbalin e hapjes së tenderëve të datës 08.04.2025**, që është 5,910.00€ më e lirë se oferta e OE të propozuar për kontratë dhe kjo përbën një shkelje të drejtpërdrejtë të këtij parimi.

Për më tepër, eliminimi i një OE-je me dokumentacion të vlefshëm dhe aktivitet të pandërprerë për arsye formale – pa u vlerësuar oferta e tij në aspektin teknik dhe financiar – **rrezikon dështimin e objektivave të prokurimit publik**, dhe shkakton dëm potencial për interesin publik dhe për buxhetin e Autoritetit Kontraktues

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura, kuptohet qartë se arsyet e eliminimit tonë nga ana e AK-së janë të gjitha të paqëndrueshme dhe të pa bazuara, andaj kërkojmë që të analizohen në tërësi të gjitha dokumentet tona dhe njëkohësisht të respektohen të gjitha dispozitat ligjore të LPP-së dhe pastaj të merret një vendim meritore në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse oferta jonë është e përgjegjshme dhe i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Në fund pasi që të vërtetohen të gjitha pretendimet tona ankimore, kërkojmë nga ana e autoritetit kontraktues që të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e **CMD SH.P.K. nga (Zejnullah Fetahu B.I.)**

ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës (B58) dhe lënda kthehet në

RISHQYRTIM dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 2,000.00€.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*
- e) Informimi-Ndryshim i Statusit Juridik të Biznesit – Zejnullah Fetahu B.I. në CMD SH.P.K.*
- f) Qertifikata e CMD SH.P.K.*
- g) Qertifikata e Zejnullah Fetahu B.I.*

